



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 378 Prot.

Gjirokastrë, më 18 / 03 /2020

URDHËR

Nr. 17, datë 18.03.2020

PËR
PLATFORMËN E MËSIMIT ONLINE

Në kushtet e ndërprerjes së procesit mësimor si pasojë e përhapjes së infeksionit COVID -19, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksionet e shkaktuara nga ky virus dhe pas udhëzimeve dhe në zbatim të rekomandimeve të MASR-së përmes zv/ministrit, datë 16.03.2020,

Urdhëroj;

1. Të përcillen cikle leksionesh në adresat elektronike të studentëve sipas programeve të studimit (të bashkëlidhura në adresat elektronike të gjithësecilit).
2. Përcjellja e leksioneve të shoqërohet me një informacion shpjegues për mënyrën e komunikimit online student - lektor.
3. Në dokumentin shpjegues të përcaktohet një orar për çdo ditë për të realizuar komunikimin direkt pyetje-përgjigje lektor - studentë.
4. Shpjegimet që lektori jep pas pyetjeve që u vijnë me shkrim nga studentë të veçantë t'iu përcillen të gjithë grupit studentor.
5. Studentëve t'u përcillen gjithashtu teste apo forma të tjera për tu plotësuar, të cilët pas realizimit të tyre ti dërgojnë elektronikisht te lektorët e tyre.
6. Për komunikimin gjithë javor lektori t'iu përcjell grupeve studentore konkluzionet kryesore si dhe vlerësimet për studentët.



7. Grupet e punës sipas njësive kryesore, janë struktura të ngritura enkas për menaxhimin e platformës së komunikimit elektronik. Njëherazi ato kanë për detyrë të përcaktojnë modulet e para që do të pilotojnë leksionet online, kryesisht ato të vitit të tretë që janë më afër diplomimit.
8. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri: zv/rektorët, dekanët, zv/dekanët, përgjigjësit e njësive bazë, përgjigjësit e grupeve mësimore, grupet e punës të ngritura sipas njësive kryesore, sektori i standarteve dhe kurrikulave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

BEKTOR
Prof.dr Bekdash MEMA

